
REZYME PËR POLITIKA PUBLIKE

Институт за комуникациски студии

QËNDRUESHMËRIA NË VEND TË DEMANTEVE: PËRGJIGJE NDAJ NDËRHYRJEVE TË HUAJA DHE MANIPULIMIT ME INFORMACIONET

prof. dr. Marina Tuneva; dr. Dragan Sekulɲovski



Rezyme ekzekutive

Ndërhyrja e huaj dhe manipulimi i informacionit (NHMI) është i "qëllimshëm dhe të koordinuar të sjelljes manipuluese", i cili mund të ndikojë negativisht në proceset demokratike dhe në besimin ndaj institucioneve. Prandaj, vendimmarrësit, organet rregullatore dhe aktorët mediatik duhet ta trajtojnë atë si një rrezik sistemik, veçanërisht në ciklet zgjedhore dhe situatat e krizës, dhe të krijojnë një përgjigje të parashikueshme, proporcionale që mbron sferën publike pa shkelur lirinë e shprehjes.

Udhëzimi kyç është që NHMI-ja të mos trajtohet si një varg incidentesh që shuhet me demantime ad-hoc, por si një rrezik që kërkon një qasje të qartë, përgjigje të parashikueshme dhe koordinim. Prandaj propozohet që qasja NHMI të ketë një kornizë operative konkrete: (1) inkorporimin e saj në politikat kyçe kombëtare, (2) një strukturë të vogël koordinuese me role të qarta dhe një protokoll standard për "incidentet informative", (3) garanci reale për pavarësinë dhe protokolle në shërbimin publik, (4) transparencë më të madhe të pronësisë dhe financimit dhe rregulla për reklamimin politik online dhe (5) një "protokoll zgjedhor" për sferën digjitale, duke përfshirë edhe sqarime të shpejta dhe të verifikueshme për përmbajtje audio dhe video sintetike ose të manipuluara.

Praktikisht, masat nënkuptojnë një kombinim midis koordinimit institucional dhe protokolleve për përgjigje të shpejtë dhe të verifikueshme, me forcimin e shërbimit publik, transparencë më të madhe në sektorin mediatik dhe rregulla zgjedhore për sferën digjitale.

Rekomandime për Qeverinë dhe institucionet

- Të inkorporohet një përkufizim dhe qasje e qartë për NHMI-në, në politikat dhe strategjitë kyçe kombëtare (siguria kombëtare, siguria kibernetike, komunikimi strategjik publik), me role dhe përgjegjësi të përcaktuara saktë ndërmjet institucioneve.
- Të formohet një strukturë e vogël, funksionale, koordinuese me mandat të qartë për monitorimin e rreziqeve, shkëmbimin e informacionit përkatës dhe harmonizimin e reagimeve të publikut në kohë të ndjeshme, pa rolin e "arbitrit të së vërtetës".
- Të vendoset një protokoll standard për "incidentet informative": kush reagon, brenda çfarë afati, me cilat burime dhe prova, si publikohen sqarimet dhe si sigurohet një komunikim i qëndrueshëm, i verifikueshëm dhe jo-polarizues.

Rekomandime për politikat rregullatore mediatike

- Të forcohet shërbimi publik përmes masave që realisht mbrojnë pavarësinë editoriale dhe llogaridhënien: zgjedhje transparente të organeve drejtuese dhe mbikëqyrëse, kritere për integritet dhe rregulla të brendshme editoriale që parandalojnë "ri-transmetimin" manipulues të narrativave të diskutueshme pa verifikim dhe kontekst.
- Të rritet transparenca në sektorin mediatik përmes mekanizmave më efektivë për informacione publikisht të qasshëm mbi pronësinë dhe financimin, si dhe rregulla të qarta për fondet publike (përfshirë edhe reklamimin shtetëror), me mbikëqyrje të pavarur dhe llogaridhënie të rregullt.
- Të sigurohet integriteti në sferën digjitale gjatë periudhave zgjedhore dhe krize përmes një "protokolli zgjedhor" kombëtar për mjedisin online: transparencë dhe etiketim i reklamimit politik, procedura për sqarime të shpejta dhe të verifikueshme për përmbajtje audio dhe video sintetike ose të manipuluara dhe koordinim me institucionet përkatëse si dhe mekanizmat e pavarur të mbikëqyrjes dhe llogaridhënies.

Pse NHMI-ja është një rrezik sistemik në Maqedoninë e Veriut?

Ndërhyrja e huaj dhe manipulimi i informacionit (NHMI) nuk përbëhet thjesht nga "lajme të rreme", por nga një model kryesisht i paligjshëm, i qëllimshëm dhe i koordinuar i sjelljes manipuluese, i cili mund të ndikojë ndjeshëm mbi vlerat, procedurat demokratike dhe proceset politike. Në fokus janë qëllimi, koordinimi, karakteri manipulues dhe përdorimi i ndërmjetësve dhe rrjeteve që lejojnë infiltrimin midis audiencave lokale dhe amplifikimin e narrativave përmes kanaleve të ndryshme.

Në kontekst kombëtar, NHMI-ja shfaqet si një dobësi e komunikimit publik jo sepse "publiku beson në gjithçka", por sepse sistemi i informimit ka vështirësi të sigurojë kritere të qëndrueshme për verifikim, kontekst dhe llogaridhënie në momentet e presionit të lartë. Pikërisht atëherë përmbajtjet manipuluese "inkorporohen" më lehtë në informimin e përditshëm mediatik: nuk kanë nevojë të bindin shumicën, mjafton të krijojnë konfuzion, lodhje nga verifikimi dhe polarizim.

NHMI-ja depërton më lehtë gjatë periudhave zgjedhore dhe krizave

Më të rrezikshme janë periudhat kur shoqëria është më e ndjeshme, gjatë zgjedhjeve, ngjarjeve të sigurisë dhe gjeopolitike, krizave ose incidenteve me ngarkesë të lartë emocionale. Pastaj ritmi shtyp verifikimin, madje edhe ndërhyrjet e vogla në kontekst mund të drejtojnë ndjeshëm përshtypjen e publikut. Në situata të tilla, përmbajtjet manipuluese nuk kanë nevojë të “bindin” shumicën. Mjafton të krijojnë lodhje, konfuzion dhe polarizim për të minuar besimin në institucionet dhe mediat.

Rreziku thellohet më tej për shkak të dobësive strukturore të ekosistemit mediatik: një treg ekonomikisht i ndjeshëm, transparencë e paplotë e pronësisë dhe financimit, varësi nga dukshmëria në platformat digjitale dhe rregulla jo të qarta për reklamimin politik online. Në një mjedis të tillë, narrativat manipuluese fitojnë lehtësisht "legjitimitet lokal" përmes përsëritjes, transmetimit selektiv dhe tonit pseudo-analitik, pa pasur domosdoshmërisht kontroll të drejtpërdrejtë mbi mediat.

Pse janë kyçe rregullat, rolet dhe rutinat?

Qasja aktuale mbetet e fragmentuar. NHMI-ja përmendet në disa politika dhe dokumente, por pa një kornizë operative të qartë që tregon se kush e monitoron fenomenin, kush e vlerëson, kush koordinon reagimin dhe si komunikojnë institucionet kur përmbajtje manipuluese shpërndahen përmes mediave dhe kanaleve online. Në këto kushte, përgjigjja shpesh vonon dhe nuk është e koordinuar: institucione të ndryshme japin mesazhe të ndryshme, ndërsa reagimi publik shndërrohet lehtësisht në debat politik, në vend që të ofrojë një sqarim të verifikueshëm që ndihmon publikun të orientohet.

Një problem shtesë është se lidhja midis kapaciteteve të sigurisë kibernetike dhe menaxhimit të operacioneve informative është e dobët. Edhe kur ekzistojnë sinjale ose indikacione teknike, ato rrallë shndërrohen në një komunikim publik të drejtëpërdrejtë dhe të qartë që redukton dëmin dhe mbetet proporcional dhe i koordinuar me të drejtat e njeriut. Kështu krijohet një "vakum" ku narrativat manipuluese stabilizohen para se të shfaqen sqarimet zyrtare, dhe mediat raportojnë në kushte mungese të informacionit të verifikueshëm.

Prandaj është i nevojshëm një kalim nga demantimet ad-hoc drejt një sistemi të parashikueshëm – role të dakorduara, protokoll standard për "incidentet informative", shkëmbim i rregullt i informacionit relevant dhe transparencë proaktive që kufizon hapësirën për spekulime. Për mediat, kjo nënkupton rutina editoriale të qarta për verifikim dhe kontekstualizim gjatë periudhave të ndjeshme, si dhe masa që zvogëlojnë "zonën gri" përmes transparencës mbi pronësinë, financimin dhe reklamimin politik online. Ky nuk është një mekanizëm për "kontroll të përmbajtjes", por një kornizë praktike për besim: rregulla dhe procedura që e bëjnë reagimin publik të shpejtë, të verifikueshëm dhe të qëndrueshëm, zvogëlojnë dëmin nga manipulimet dhe njëkohësisht ruajnë lirinë e shprehjes dhe pluralizmin mediatik.

Si ta kuptojmë shpejt NHMI-në (në 4 kategori)

Për një vlerësim praktik, është e dobishme të ndiqet një "matricë" me katër pyetje:

Aktorët:

kush qëndron pas aktivitetit (aktorë shtetërorë/jo-shtetërorë dhe ndërmjetës).

Sjellja/ taktikat:

cilat teknika përdoren (koordinimi, rrjetet e fshehta, përforcimi, autenticiteti i rremë).



Kanalet:


ku shihet aktiviteti (portale, rrjete sociale, video platforma; linqe/postime specifike si provë).

Efektet/ objektivat:

çfarë arrihet (polarizimi, rënia e besimit, çmobilizimi, presion mbi institucionet/ mediat).

Burimet e konsultuara

- Tuneva M., Sekullovski D. (2026). Ekosistemi mediatik dhe ndërhyrja e huaj dhe manipulimi me informacionet në Maqedoninë e Veriut.Shkup: Instituti për Studime të Komunikimit (ResPublica).
- Blair-Simon K. (2025). Dokument për politika publike: Adresimi i ndërhyrjes së huaj dhe manipulimi i informacionit në kontekstin e rregulloreve Evropiane. Shkup: Instituti për Studime të Komunikimит (ResPublica).
- Haxhi-Janev, M., Stoilkovski, M. (2025). Ndërhyrja e huaj dhe manipulimi me informacionet në Republikën e Maqedonisë së Veriut - Analiza fillestare. Shkup: Instituti për Studime të Komunikimit (ResPublica).
- European External Action Service (EEAS) (2023). Foreign Information Manipulation and Interference (Fimi): A Framework for Analysis. Brukseli: EEAS.



Më shumë mbi temën e kësaj rezymeje shpjegohet në dokumentin për politika publike

"EKOSISTEMI MEDIATIK DHE NDËRHYRJA E HUAJ DHE MANIPULIMI I INFORMACIONIT NË MAQEDONINË E VERIUT"

Институт за комуникациски студии

www.iks.edu.mk **info@iks.edu.mk**

British Embassy Skopje

UK International Development
Partnership | Progress | Prosperity

Ky produkt është përgatitur në kuadër të projektit "Monitorimi, zbulimi dhe ekspozimi i ndërhyrjeve të fshehta të huaja dhe manipulimit të informacionit", financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, me mbështetjen e Ambasadës Britanike në Shkup. Mendimet dhe qëndrimet e shprehura në këtë përmbajtje nuk pasqyrojnë çdo herë mendimet dhe qëndrimet e Qeverisë Britanike.